



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian
Mbledhja nr. 83

Prishtinë: Dt. 19.04.2024, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Agon Batusha, Alban Bajrami, Shqipe Isufi, Driton Hyseni, Elmi Reçica dhe Blerta Deliu-Kodra.

Munguan: Fjolla Ujkani, Fridon Lala dhe Time Kadrijaj.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 05.03.2024;
3. Raportim i znj. Rozeta Hajdari, ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-207 për tekste shkollore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 05.03.2024

Procesverbali u miratuan pa vërejtje.

3. Raportim i znj. Rozeta Hajdari, ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;

Kryetarja falënderoi ministren, që i është përgjigjur ftesës dhe tha se qëllimi ftesës është të raportojë lidhur me përmbushjen e obligimeve të ministrisë, që kanë të bëjnë me proceset integruese të vendit dhe ky raportim është shumë i rëndësishëm, sepse MSA, në pjesën më të madhe, përmban obligimet nga aspekti tregtar.

Rozeta Hajdari, ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, tha se do të fillojë me vitin 2023.

Është kënaqësi që në emër të ministrisë, të prezantoj para jush arritjet dhe rëndësinë që ka për neve procesi i integritit evropian, si dhe përmbushja e obligimeve që rrjedhin nga MSA, si dhe Agjenda për Reforma Evropiane. Misioni kryesor i kësaj ministrie është përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe zhvillimi i konkurrueshmërisë, duke zhvilluar industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë. Plani Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) dhe Agjenda për Reforma Evropiane (ARE), janë dy dokumentet bazë, mbi të cilat Qeveria bën prioritetizimin e aktiviteteve dhe objektivave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në kuadër të kësaj, kemi përmbushur shumë obligime, të cilat kanë rezultuar pozitivisht edhe në raportin e fundit të Komisionit Evropian, i cili përveç shumë arritjeve të Qeverisë, në veçanti, e vlerëson si progres të dukshëm plotësimin e kornizës legjislative, në përputhje me direktivat e BE-së, të hartuara nga kjo ministri, e po ashtu vë në pah përmirësimin e dukshëm të mbikëqyrjes së tregut, si dhe rritjen e performancës së Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), duke e quajtur si përmirësim të fuqishëm.

Për të plotësuar kornizën ligjore, vetëm gjatë vitit 2023 janë miratuar 7 ligje, 12 udhëzime administrative dhe 3 rregullore. Në vazhdim, do të theksoj masat e realizuara dhe arritjen e progresit, lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) për vitin 2023, si dhe aktivitetet që jemi duke i ndërmarrë në realizim të masave të planifikuara për vitin 2024, në kuadër të Planit Kombëtar për Integrim Evropian. Vendimi për publikimin e listës me titujt dhe referencat e standardeve të harmonizuara për pajisjet elektrike të destinuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit, është miratuar.

Me datë 29.12.2023, është miratuar vendimi me listën e standardeve të harmonizuara për pajisjet elektrike të destinuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit. Është miratuar vendimi për publikimin e listës me titujt dhe referencat e standardeve të harmonizuara për pajtueshmërinë elektromagnetike, më datë 29.12.2023 është miratuar vendimi me listën e standardeve të harmonizuara për pajtueshmërinë elektromagnetike. Grupi punues është duke e hartuar koncept-dokumentin. Njësia për informimin e bizneseve është e funksionalizuar Themelimi i Qendrës së

Informimit për Standarde (Info Center), ka përfunduar dhe si e tillë, ofron të gjitha shërbimet për informim, konsulencë dhe bashkëpunim me të gjitha palët e interesit.

Skema e akreditimit për trupat certifikuese (EN ISO/IEC 17065), e themeluar dhe e funksionalizuar (PKIE dhe ERA 2) Skema e akreditimit për trupat certifikuese është në funksion. Gjatë vitit 2023 në DAK nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për akreditim nga ndonjë trup certifikues (TC), sipas kërkesës së standardit EN ISO/IEC 17065.

Laboratori i forcës dhe termometrisë, i akredituar, ka marrë pjesë në ndërkrahime laboratorike me Institutin e Metrologjisë në Turqi (TUBITAK UME) dhe jemi në pritje të rezultateve. Ndërsa, sa i përket laboratorit të termometrisë, jemi në fazën e përgatitjes për ndërkrahime. Së paku, 10 zyrtarë të rinj në Inspektoratin e Tregut, të rekrutuar. Shpallja e 27 pozitave për zyrtarë të rinj në Inspektoratin e Tregut është bërë dy herë gjatë vitit 2023, kur janë rekrutuar 7 zyrtarë të rinj, të cilët i kanë plotësuar kriteret, është përsëritur shpallja, tani është në proces të rekrutimit për 21 zyrtarë të rinj.

Është bërë inicimi i procedurave për rekrutimin e dy zyrtarëve nga AMK dhe MINT. Procedurat për rekrutimin e zyrtarëve kryhen nga MPB, dhe gjatë vitit 2023, nuk kanë filluar procedurat nga MPB. Por në këtë vit jemi në proces të rekrutimit për tri pozita tjera, sipas përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësi, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Standardi EN ISO/IEC 17020 për laboratorët e metrologjisë ligjore (laboratori i masës, laboratori vëllim-rrjedhje, laboratori i matjeve elektrike dhe laboratori i presionit), i zbatuar.

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar puna në ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC) për të gjithë laboratorët e metrologjisë ligjore, sipas kërkesave të Standardit ISO/IEC 17025:2017, (ku është i përfshirë edhe standardi 17020) dhe është realizuar sipas planifikimit, si dhe janë nënshkruar deklaratat e konfidencialitetit. Puna në zbatimin e këtyre standardeve do të vazhdojë edhe më tej. Sistemi online për shitjen e standardeve, i funksionalizuar. Platforma elektronike për shitjen e standardeve ishte pjesërisht e funksionalizuar gjatë vitit 2023, mirëpo është funksionalizuar plotësisht gjatë fillimit të këtij viti, 2024.

Sa i përket kapitullit të tretë: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve, kemi arritur të digjitalizojmë më shumë sektorë të shërbimeve.

Kryetarja, tha se pasi e kemi raportin tuaj dhe besoj të gjithë e kemi lexuar, po fillojmë njëherë me pyetjet e pastaj vazhdojmë me vitin 2024. Në vazhdim, tha se ju ministre iu referuat disa herë Raportit të progresit, por në këtë raport është thënë se ende mbetet shqetësues korrupsioni, por ajo po mbetet të jetë ende shqetësuese se po shohim dita-ditës se çka po ndodh me këtë qeverisje.

Për anëtarësim në BE, kriter kryesor është sundimi i rendit dhe ligjit dhe lufta kundër korrupsionit, ndërsa ju, para disa ditëve, jeni ftuar nga Prokuroria Speciale, lidhur me rezervat shtetërore dhe keni thënë se nuk keni qenë, por Prokuroria Speciale ka dalë me një komunikatë se jeni marrë në pyetje nën dyshimin se keni kryer veprë penale, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me rezervat shtetërore. Andaj, na tregoni cila është e vërteta, sepse nuk po dimë më cila është e vërteta?

Në ndërkohë kishte reagime nga pozita se po devijohet tema.

Kryetarja, tha unë jam kryetare dhe po ja jap fjalën ministres që ta dimë të vërtetën.

Ministrja Rozeta Hajdari, tha se Kosova së pari është e vlerësuar në të gjitha raportet rajonale ndërkombëtare, si e para për qeverisjen e mirë, për indikatorët e demokracisë, për përmirësimin e ambientin e të bërit biznes, ku Kosova me politikën e mirë të bërit biznes dhe qeverisjen e mirë është e para në rajon, gjithnjë duke iu referuar raporteve të OCD-së dhe të raporteve botërore për rritjen ekonomike, si dhe raportet e treguesve demokratikë, kështu që kjo që ju po i referoheni, nuk qëndron. Kurse sa i përket pyetjes që i referoheni prokurorisë, unë sot jam në raportim për proceset e integritimit evropian. Pasi që kemi disa ligje që janë për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, unë pres nga prokuroria diçka konkret. Unë, si ministre, pritet që të deklasifikohet dhe të raportohet sipas pyetjeve që ata mund të m'i dërgojnë. Ky është qëndrimi im dhe sot përgjigjem vetëm për integritime evropiane.

Kryetarja theksoi se kjo ka të bëjë me raportin për vendin dhe vetëm duhet të na tregoni ministre, a ke qenë a nuk ke qenë në prokurori dhe a ke dhënë intervistë?

Ministrja, tha se ku e di ti a kam dhënë apo nuk kam dhënë intervistë dhe unë nuk punoj me psikologjinë tuaj të pasqyrës dhe jam e hapur për çdo pyetje. Kur të intervistohem, të tregoj.

Nga deputetët e pozitës kishte reagime për kryetaren e Komisionit, duke i thënë që mos ta keqpërdorë foltoren, se i ke 5 minuta për pyetje dhe 2 minuta për replikë dhe na jep fjalën të tjerëve.

Kryetarja, tha se komunikatës së prokurorisë, çka t'i bëjmë ne dhe ende nuk e mora përgjigjen prej ministres.

Ministrja, tha se merreni procesverbalin dhe e shihni aty çka ka ndodhur dhe si jam deklaruar. Unë nuk raportoj pa u deklasifikuar informatat, edhe pse ty po të vjen rëndë, shko merre raportin në prokurori, në rrugë zyrtare. Deri më tani, për cilat masa më pyete, për asnjë masë.

Driton Hyseni, i tha kryetares se na ke ftuar në takim për integritime evropiane e jo për të folur për kauzat tuaja politike dhe tha se a ka mundësi të na jepni fjalën dhe ushtrije mandatin e kryetares në përputhje me rregulloren e punës dhe ruaje korrektësinë që e ke pasur vazhdimisht.

Kryetarja pyeti: Luftimi i krimit dhe korrupsionit, si nuk është proces integruar dhe pse nuk keni ardhur në Komision Hetimor për rezerva shtetërore ?

Driton Hyseni, pyeti ministren: Çka ka ndikuar në masat që nuk janë përmbushur 100% dhe cilët kanë qenë indikatorët, a ka qenë puna edhe me institucione tjera që kanë ndikuar në këtë? Kjo është çështja që neve na preokupon, sepse jemi të thirrur në bazë të detyrës që të tentojmë maksimalisht për t'i nxitur institucionet t'i përmbusheshin masat të cilat lidhen me Programin kombëtar të integritimit evropian, me qëllim që procesi ynë integruar të ketë një përmbajtje sa më të plotë dhe ne të vazhdojmë tutje me rrugën e integritimeve evropiane. Çështja tjetër, ka të bëjë me marrjen e vendimit në Qeveri për themelimin e zonës industriale në Komunën e Podujevës dhe përgëzoi ministren për punën e bërë, sepse është një mundësi e mirë për të gjithë ata afaristë që dëshirojnë të investojnë dhe dëshirojnë të bëjnë afarizëm në këtë komunë. Ngriti edhe çështjen e ngritjes së konkurrencës në tregun e Kosovës, në të gjithë sektorët e tregjeve. Në vazhdim, tha se ne kemi një autoritet të konkurrencës, që i raporton

direkt Kuvendit, por mendoj që ka nevojë për një relacion shumë të ngushtë edhe me ministrinë, e sidomos me Inspektoratin e Tregut, kur ka shkelje brutale të konkurrencës. Sa mund të bëhet më shumë drejt shtrëngimit të relacioneve me Autoritetin e Konkurrencës, në drejtim të rritjes së nivelit të konkurrencës në trend me nivelet e konkurrencës të BE-së. Në fund, derisa të ndodhë ristrukturimi i KIES-së, i paraparë me ligj, sa është e nivelit të kapacitetit të nevojshëm që KIESA të bëjë punën e vet në drejtim të përmbushjes së detyrave që ka, para se të themelohet agjencia, që parashihet për investime dhe eksport.

Ministrja, tha se lidhur me rritjen e konkurrencës së ndërmarrjeve tona, është bërë shumë punë gjatë vitit 2023, ku kemi përmirësuar legjislacionin për përmirësimin e ambientit e të bërit biznes, rritjen e besueshmërisë për investime në Kosovë, për të cilat raportet botërore kanë dëshmuar që Kosova po performon mirë e më mirë, krahas vendeve të rajonit. Mund t'i përmendi tri ligje të rëndësishme, që kanë kontribuar, si dhe politika industriale me instrumentet kanë ndikuar në planet e veprimit, deri në vitin 2026, ku janë duke u përkrahur shumë ndërmarrje në avancimin e makinerisë në digjitalizim dhe certifikim, në standardizim në trajnim për të pasur mundësi për t'u integruar në tregun rajonal dhe botëror. Ndërmarrjet tona kanë një potencial të pashpalosur, sepse janë me kapacitet prodhues, por që nuk kanë pasur ndihmën e mjaftuar nga vitet e mëhershme dhe tani përmes Fondit për garantimin e kredive, ne po ndihmojmë vit për vit 10 deri 20 milë ndihmë për marrjen e kredive për avancim të makinerisë për të prodhuar me kualitet edhe për eksport.

Janë edhe ligjet për falimentim, ligji për shoqërinë tregtare, ligji për pronarin përfitues që ndihmojnë një konkurrencë të shëndoshë në vendin tonë. Është ofruar bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës, ku përmes procesit të racionalizimit të agjencive, do të shikohet edhe një modalitet më i përafërt bashkëpunimi me Ministrinë e Tregtisë dhe Autoritetit të Konkurrencës, jo vetëm zona ekonomike në Podujevë, por janë 10 zona të certifikuara, por jo të funksionalizuara dhe me 33 milë nga buxheti i Kosovës janë duke u funksionalizuar këto zona me investime kapitale nga Ministria e Industrisë. Kemi në proces plan të certifikimit, parku dy i Drenasit, në Lipjan Rahovec dhe duke u përgatitur procedurat për parkun në Bërnice dhe aplikimet nga komunat e rajonit të Dukagjinit për certifikim të zonave ose parqeve industriale teknologjike dhe bashkëpunimit më të afërm me universitetet në rajonin e Dukagjinit dhe Prishtinës.

Blerta Deliu- Kodra, tha se më e pakta që do të duhej ju të bëni si ministre, është të jepni dorëheqje. Kërkoj të më adresoheni saktë në adresimin që e kam sot, si deputete. Duhet të ndjeheni llogaridhënëse, sepse po flisni për një ambient të shëndoshë të bërit biznes në Kosovë, e që ka akuza për vjedhje të rezervave shtetërore, e mos t'i përmendi edhe rastet tjera të mosdeklarimit të pasurisë dhe rastin e shumëpërfolur me skandalin në revistën franceze. Ju që i keni akuzuar mediat në prokurori se janë kriminale dhe po krijojnë dosje që janë të paqena. Sot nuk mund të vini para përfaqësuesve të popullit, sikur nuk ka ndodhur asgjë në Kosovë. Nuk mundemi të flasim në Kosovë për proceset integruese dhe as për reformën e agjendës evropiane, kur nuk është dhënë përgjegjësi për skandalin e shumëpërfolur për rezervat shtetërore. Ju e dini se sa përpjekjet janë bërë nga kolegët deputetë, për ta bllokuar Komisionin për rezervat shtetërore, a ndjeni një pikë përgjegjësie institucionale, të një kryeministri që na ka thënë për vite të tëra që në qeverinë e tij nuk do të ketë ministra me aktakuza?

Pse jeni këtu sot për të folur për një proces të reformimit, kur reformat kryesore janë për afera korruptive, janë 600.000€vlera e mallit , po flasim për vaj, sheqer dhe grurë? Nuk mund t'i mbyllë sytë dhe të thoni sot mos na pyetni për keqpërdorime. Çka duhet të ndodhë edhe më shumë, që sot në pozicionin e një ministri, mos të jepni llogari institucionale dhe morale që ka?

Ju nuk mund të thoni që sot keni ardhur të flisni për ERA-n dhe agjendën e reformave evropiane, sepse sot kapitulli i BE-së, qartë na thotë se luftimi i krimit dhe i korrupsionit është parimi i parë në të cilën duhet të kemi një qeveri kredibile. Pyetja ime e parë dhe e vetme sot është, kur do të ofroni dorëheqje?

Ministrja, tha se së pari unë kam ardhur të raportoj për masat konkrete, të cilat janë në planin vjetor 2023, por do të kisha shpjeguar edhe lidhur me planin vjetor 2024. Po kuptoj nga ju që nuk jeni të interesuar për reforma dhe për integrimet evropiane dhe masat që i ka ndërmarrë ministria jonë dhe ministrët tjerë, që janë të dëshmuara në Raportin e progresit. Unë shfrytëzoj të drejtën e ligjit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, neni 52 dhe 54 i ligjit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe mbrojtjen e rezervës shtetërore, neni 9 dhe 10 i ligjit për rezervën shtetërore. Andaj, nuk do t'ju përgjigjem as për llojin, e as për sasinë, as për vlerën, sepse mandalon ligji ,andaj lexoji ligjet dhe pastaj e kupton se nuk ke të drejtë të më pyesësh për këto. Kurse lidhur me dorëheqjen time, është dikush më i lartë se unë, Kryeministri i Kosovës që ai vendos për ministrat e tij. Andaj, ndihem shumë llogaridhënëse dhe e pastër para qytetarëve të Kosovës, ku gjatë vitit 2022, rezervat shtetërore janë rritur 30 fish, sepse rezervat shtetërore kanë qenë jo në funksion të ndërhyrjes në rastet e çrregullimit në treg dhe rastet e tjera të parapara në nenin 2 të ligjit për rezervat shtetërore. Sesi ju e keni lënë qytetarin e Kosovës në qeverisjen e juaj, tregon buxheti i Republikës së Kosovës. Nuk flas më tepër, sepse janë ligjet në fuqi dhe pres qartësime shtesë nga të gjitha institucionet, që të tregojnë sesi është më së miri të ruhet sekreti, të mbrohet dhe mos të komprometohet. Kam raportuar në Komisionin për rezerva shtetërore, me dyer të mbyllura, kam dhënë të gjitha qartësimet, vit pas viti, siç jam ftuar. Për më tepër, ju nuk jeni trup gjykues të më bëni pyetje, jam për raportim për integritet evropiane.

Blerta Deliu- Kodra, tha se, e para, këtu nuk ka llogaridhënie dhe i tha deputetit Hyseni, këshilloje ministren. Po ju kuptoj se vështirë e keni këtë përpjekje që po e bëni për ta mbrojtur, por përgjegjësinë morale më të vogël ta kishit, ministre, sot nuk do të duhej të ishit në raportim, sepse dorëheqja është për ju, sepse sot përgjegjësinë më të madhe duhet ta jepni para qytetarëve të Kosovës, sepse nuk vidhet në rezervat shtetërore.

Ministrja iu drejtua kryetares së Komisionit, duke e pyetur se ku e ke aktakuzën në prokurori, nuk është e vërtet që kam thënë në media se nuk kam qenë në prokurori.

Kryetarja, tha se unë të pyeta se a ke qenë apo nuk ke qenë, se nuk po di kush po e flet të vërtetën, prokuroria apo ti, se ti ke thënë se kam qenë në prokurori, por më kanë pyetur për disa ligje, kurse ata kanë dalë me komunikatë, që ke qenë për rezerva shtetërore.

Ministrja, tha se është reagimi i avokatit tim mbrojtës që e kam dhënë unë me gojën time, që unë isha sot në prokurori e ftuar dhe prita t'i marr sqarimet për dhënien e dokumentacionit, i cili është i klasifikuar, sekret, dhe nuk munda ta realizoj intervistën, për shkak se duhet të merren qartë për deklasifikim të lëndës, si sekret. Sepse, nuk mund t'i shkeli nenet e ligjeve. Jemi të hapur për çdo raportim që kërkohet qartësi, sepse sipas raportit të Inspektoratit të Policisë, janë marrë në mënyrë të parregullt dokumentet, sepse janë marrë informacionet pa vendim të deklasifikimit, si merret një sekret i shtetit, pa u deklasifikuar, së pari kur unë raportoja para Komisionit për rezerva shtetërore, me dyer të mbyllura, sepse m'i mbyll dyert ligji për rezervat shtetërore, pastaj kur deklasifikohen, më ftoni ju dhe i përgjigjem secilit, pra mos aludoni.

Alban Bajrami, i tha kryetares, së pari është shqetësuese qasja juaj, sepse e merr të drejtën të thoni se unë vendosi kush flet e kush jo, por ti je kryetare e këtij komisioni, sepse ka anëtarë tjerë dhe nëse ne hiqemi, t'i nuk mundesh të jesh kryetare dhe juve ju takon roli i mbarëvajtjes së një takimi, sepse të gjithë anëtarët janë të barabartë dhe kjo është gabim, si ju po veproni.

E dyta, ministre, qytetarët duhet ta kuptojnë se ky komision është i përhershëm dhe të gjitha ligjet kalojnë në këtë komision, duke shikuar se a janë në bashkërendim me ligjet e BE-së. Opozita nuk i voton dhe i bllokun. Andaj, i kuptoj deputetët pse nuk duan të flasin për raportin, sepse është i gjatë dhe duhet të lexohet, prandaj është më lehtë për të nxjerrë kryetituj, çka dalin nëpër gazeta. Më herët, kryetarja tha se prokuroria shumë shpejt do të dalë me aktakuzë, qysh ka për të qenë aktakuza, sepse po e dimë që në Kosovë ka dalë i pafajshmen njeriu në rastin "pronto", pastaj kur në Kosovë, kur nuk u raportua për fondin 3%, sa para i ka dhënë mërgata jonë. Nëse duam të flasim çka të na bie ndërmend, ka studio televizive, që iu lënë të flisni çka t'u bie ndërmend. Ideja është se e keni keqpërdorur dhe pastaj po thoni pse nuk po na vijnë ministrat. Me këtë qasje nuk vijnë në Komision. Pse nuk shtroni pyetje që janë në interes për popullin?

Kryetarja, tha se mua më interesojnë gjërat bazike, ku është mielli e ku është vaji, rezervat shtetërore, këto janë në interes për popullin.

Alban Bajrami, tha se e keni përfaqësuesin në Komisionin Hetimor, pse nuk ke ardhur në Komisionin Hetimor për hetimin për dhunën në familje. Arben Gashi, në seancë, tha se ti dhe Vlora Dumoshi jeni caktuar në atë komision.

Kryetarja tha se unë nuk kam qenë e caktuar në atë komision, gabim e ke, jam në Komisionin Hetimor për punë të jashtme.

Elmi Reçica, i tha ministres se përveç që i raporton Kryeministrit, je e obliguar me Kushtetutë dhe Rregullore të Kuvendit për të raportuar edhe në komisionin që të thërret. Këtu është komision parlamentar dhe është një çështje konkrete, por deputetët kanë të drejtë të dalin edhe jashtë saj. Nuk e besoj që një deputet i qytetarëve, të cilët po pyesin shumë nuk i intereson profili yt, veç je duke na e lexuar raportin, planet për integrim evropian. Si do të shkosh në integrim evropian kur i ke dy dënime gjyqësore, për mosdeklarim të pasurisë dhe aksident të komunikacionit, a ke akuzë për këto? Po thua se është i caktuar neni për sekrete shtetërore, po është neni i përcaktuar për sekrete, por jo për

keqpërdorime. Ku do të shkosh kështu në Evropë dhe a je e vetëdijshme se opinioni, për shkak të skandaleve, ta ka ndërruar emrin prej Rozetës në Rezerva.

Shqipe Isufi, tha se Komisioni Hetimor për rezerva shtetërore, që është themeluar dhe votuar në Parlament dhe ku i kemi qar ne përfaqësuesit tanë dhe e kanë udhëhequr kolegët tuaj dhe kanë qenë kryesues, po e jap sqarimin si anëtare e atij komisioni, mos t'i devijojmë gjërat dhe mos jepni konstatime si ministre ke vjedhë. Unë për vete nuk e marr guximin t'i them dikujt ke vjedhur dhe ik jep dorëheqje. Te Komisioni për rezerva shtetërore, e kemi kushtëzuar rrjedhën e komisionit me pjesëmarrjen në atë komision. Ne si pozitë, me 6 deputetë e kemi kushtëzuar me votimin e 360 milë marrëveshje ndërkombëtare, sapo janë votuar 3 marrëveshje ndërkombëtare, pastaj ne kemi qenë më të rregulltit. Kryesuesi, z. Ferat Shala, ka marrë pjesë i vetëm me deputetët e pozitës. Ju kisha lutur t'i pyesni deputetët e juaj në Komision hetimor, hajde dy muaj kanë qenë të kushtëzuar me marrëveshje ndërkombëtare, por 4 muaj tjerë, cili ka qenë veprimi që e kanë bërë anëtarët e Komisionit për rezerva shtetërore, pse nuk e kanë ftuar ministren aty? E vetmja punë që është bërë në atë komision, ka qenë propozimi im është që e kemi dërguar një kërkesë në prokurori, se deri ku guxojmë të shkojmë me hetim, që mos të prekim në kompetenca të prokurorisë. Tash, konsideroj se ministrja ka ardhur të raportojë për krejt diçka tjetër, por e ndjeva si obligim, si anëtare e atij komisioni, ta sqaroj për opinionin publik. Pyetje konkrete ministre, e përmendet Agjencinë për përkrahjen e ndërmarrjeve, është themeluar, por nuk është funksionalizuar, andaj cili është problemi, pse nuk përkrahen, kur ne si deputetë e kemi votuar ligjin për investime të qëndrueshme në Kuvend?

Agon Batusha, tha se pa dashur të kthehem për atë që u tha për mbarëvajtjen e mbledhjes së komisionit, ky komision është i vetmi që mund të shikojë Raportin e progresit dhe të gjitha çështjet që lidhen me BE-në, ne detaje, kurse komisionet tjera nuk mundën se kanë punë tjera, por ne po dalim në tema tjera dhe po e keqpërdorim. Unë jam vetëm në këtë komision, por ju të tjerët jeni edhe në komisione tjera dhe mund t'i trajtoni në ato komisione, si Komisionin për Ekonomi, Komisioni për Legjislacion etj., e jo të shtrohen në këtë komision, ku krejt koha na shkoj për një çështje e cila u traumatizua opinionin publik, pa asnjë fakt, sepse pyetja që shtrohet është se si ju po e dini sa sasi po mungon ose ku është vendi i fshehur i rezervave shtetërore, ku po i merrni këto pre supozime, me këtë punë merret prokuroria. Ne kemi mbi 200 dosje prej ardhjes në qeverisje që i kanë dërguar dhe asnjë dosje nuk po merret për bazë për qeverisjet e juaja. Kjo është lufta kundër krimit dhe korrupsionit, të ketë drejtësi edhe nëse gjendet diçka këtu, atëherë ne e thërrasim ministren dhe i kërkojmë llogari. Për momentin, janë krejt supozime, sepse askush nuk ka parë dokumentacione, sepse secili dokument që del në publik duhet dhënë llogari qysh e ke nxjerrë atë sekret shtetëror ose nuk po e kuptojmë logjikën çka është shteti. Ministria i ka bërë 7 ligje, 12 udhëzime administrative dhe 3 rregullore dhe 9 masa nuk janë plotësuar, kanë vonesa. Pyetja është se a mundën këto vonesa të zhblllokohen? Ne kemi çështje si çmimi i naftës, është pritur shumë mirë nga qytetarët, por është reaguuar shumë nga opozita, sepse sa shqetësohet opozita për qytetarin, është sa që për produkte bazike e ka dërguar ligjin në Gjykatë Kushtetuese dhe nuk po mund t'i rregullojmë çmimet për produktet bazike për qytetarët e Kosovës, për bukë për vaj dhe kjo është opozita.

Pyetja është ministre, se cilat janë planet e ministrisë suaj për aspektet e agjendës së reformës evropiane për këtë vite, a keni ndonjë shifër dhe a mund të arrini në masën më të madhe? Sepse, një gjë që dua ta them në komision dhe për hir të komisionit, se prej që ka ardhur kjo Qeveri, ka kapërcyer përqindja e zbatimit të masave dhe planeve të veprimit të reformave të agjendës evropiane.

Kryetarja: Agon, nuk e di për çfarë procese integruese po flet, kur tash në qershor po bëhet një vit që po bëhen, që jemi me masa nga BE-ja.

Agon Batusha: Ku je ti, si kryetare, që nuk lobon për vendin tënd, duhet shpjeguar për cilat masa, sepse Hungaria e ka bllokuar dhe pse janë ardhur masat? Për korrupsion e krim jo, por për shkak se keni kërkuar koordinim. A i bëmë ligjet që duhet për të shkuar me proces të referendumit për krejt Kosovën, pse nuk po hiqen masat? Për shkak se ta kanë bërë veton në BE dhe pse nuk iu qiten masat Serbisë për shkak se Hungaria, Orbani ka thënë nuk ia jap votën. Dhe kur ti i kupton proceset integruese, nuk iu bën presion qytetarëve me dezinformata.

Kryetarja, tha se ku kamë shkuar, kam lobuar për t'u hequr masat, sepse kur dalë jashtë vendit, unë nuk e shaj Kosovën dhe ty nuk të ka rënë të vish me mua në parlamente evropiane, po kanë qenë kolegët tuaj deputetë dhe e dinë si flas unë dhe masat janë vendosur nga BE-ja, për shkak të keq-qeverisjes.

Elmi Reçica: Sipas mediave dhe informacioneve që kanë qasje në dosje të prokurorisë, thuhet qartë se mungojnë 20.000 litra vaj, 120.000 kg sheqer dhe 52 tonë dru. A është kjo jashtë asaj që e keni blerë dhe e keni dëmtuar buxhetin e shtetit për 1 mil.€ në berëz më shtrenjtë?

Ministrja: Edhe një herë po ta shqiptoj shqip, se ligji për rezervën e ka një komision të veçantë për rezervën shtetërore. Unë nuk e shkeli ligjin, siç e shkeli ju. Ju po nxirrni informacione të klasifikuara, si sekret, ju mbani përgjegjës tuaj, sepse nuk e kam në mendje t'iu përgjigjem për çështje të vlerës, sasisë, shumës dhe vendndodhjes, sepse ma ndalon ligji. Kush të dojë, le të merret me ato kallëzime. Unë nuk merrem, është puna e drejtësisë. Kam pritur që sot do të përgjigjem për planin për integritet evropiane, nuk shoh asnjë interesim përpos deputetëve të cilët i falënderoj që më bënë pyetje për reformat në integritet evropiane. Në vazhdim, po i përgjigjem pyetjes së bërë nga deputeti për masat e marra, sa i përket furnizimit dhe transparencës së tregut të naftës, ku 98% të operatorëve të naftës janë regjistruar, licencuar, kanë qenë kryesisht mbi 50% të palicencuar, sepse licencat kanë qenë prej 15 deri 20.000€. Për ta lehtësuar licencimin e tyre, ne kemi ndërmarrë përmes barrës administrative, zvogëlimin e tarifave për marrjen e licencave të naftës dhe duhanit. Bizneset tona më falënderojnë çdo ditë e më shumë, se po i marrim licencat pa dhënë para në xhepat e zyrtarëve të ish- ministrave, siç ka ndodhur më herët. Vetëm gjatë vitit 2023, kemi rritur 68% inspektimet dhe rritjen e mbikëqyrjes së tregut, ku ka rezultuar me suksese, kurse lidhur me përkrahjen e ndërmarrjeve, është ligji për investime të qëndrueshme, ku është theksuar në Raport të progresit, për vitin 2023, si arritje e madhe për Kosovën, por kjo e arritur të nesërmen është dërguar në Gjykatën Kushtetuese. KIESA, tani është në funksion dhe ka treguar edhe rritje të performancës gjatë viteve ku edhe theksohet edhe në Raportin e progresit.

Elmi Reçica, tha se askush nuk po ta kërkon vendndodhjen ose shkeljen e ligjit për sekretet shtetërore, por po të kërkojmë për keqpërdorimet, për të cilat janë duke u zhvilluar hetimet.

Së dyti, unë i kam shkelur vetëm ligjet e Serbisë, që ta ka mundësuar ty për të ardhur këtu edhe ty, për t'u bërë ministre. Je e dënuar dhe marre duhet të të vijë sesi e ke arsyetuar shkeljen e një fëmije.

Ministrja, tha se ofendimet mbaj për vete, fëmija është një engjëll, që pahiri mund të dalë përpara dhe shihe realitetin me video dhe duhet të të vijë turp për shpifjet që po i bën.

Pastaj, ministrja e lëshoi mbledhjen.

Kryetarja pastaj vazhdoi me pika të tjera të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-207 për tekste shkollore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me projektligjin , e hapi debatin dhe e hodhi ne votim.

Pas votimit, konstatoi se Komisioni nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor, lidhur me projektligjin, pastaj e hapi debatin dhe e hodhi në votim.

Pas votimit, konstatoi se Komisioni nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor, lidhur me projektligjin, pastaj e hapi debatin dhe e hodhi në votim.

Pas votimit, konstatoi se Komisioni, edhe për këtë Projektligj, nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Rrezarta Krasniqi